

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Letërnjoftimi i Komunës së Hanit të Elezit 2012

Korrik, 2012

“Letërnjoftimi i Komunave” është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Përmbledhje ekzekutive..... | 3 |
| 1. Problemet në Komunën e Hanit të Elezit | 5 |
| 2. Performanca buxhetore e Komunës së Hanit të Elezit | 6 |
| 3. Investimet kapitale..... | 9 |
| 4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011 | 11 |
| 5. Administrata e Komunës së Hanit të Elezit | 11 |
| 6. Arsimi në Komunën e Hanit të Elezit | 12 |
| 7. Shëndetësia në Komunën e Hanit të Elezit | 14 |
| 8. Transparenca | 15 |
| 9. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009..... | 18 |
| 10. Burimet | 21 |

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Hanit të Elezit është e vetmja komunë e cila udhëhiqet nga kryetari i cili nuk ka ardhur në krye të këtij institucioni nga subjektet politike. Në zgjedhjet e kaluara lokale të mbajtura në nëntor të 2009 Refki Suma kandidoi si i pavarur.

Zgjedhjet për kryetar të Hanit të Elezit janë zhvilluar në dy raunde. Në balotazh kanë hyrë Refki Suma dhe kandidati i PDK-së Mehmet Ballazhi. Kandidati Suma në balotazh ka pasur mbështetjen politike nga LDK dhe AAK dhe në balotazh ka fituar 53.6% të votave.

Në fillim të mandatit, më 2010, Refki Suma ka arritur marrëveshje me LDK dhe AAK për të bashkëqeverisur Hanin e Elezit, kurse PDK është pozicionuar si parti opozitare në Kuvendin Komunal. Nga kjo marrëveshje pozita e nënkryetarit të komunës i ka takuar LDK (Muzafer Dernjani), ndërsa pozita e kryesuesit të Kuvendit AAK (Mehdu Vlashi). LDK dhe AAK udhëheqin edhe me disa drejtori komunale: LDK udhëheq me tri drejtori (Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Bujqësisë), AAK me një drejtori (Drejtorinë e Shërbimeve Publike), ndërsa katër drejtori tjera udhëhiqen nga kandidatë të pavarur të cilët janë përzgjedhur nga Kryetari i Komunës (Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Urbanizimit, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik).

LDK dhe AAK i mundësojnë ekzekutivit që të ketë shumicën e asambleistëve edhe në Kuvendin Komunal. Nga gjithsej 15 ulëse sa ka Kuvendi i Hanit të Elezit, gjashtë janë nga LDK, tre janë nga AAK dhe gjashtë të tjerë nga PDK.

Hani i Elezit është formuar si komunë e re në vitin 2006, fillimisht si pilot njësi komunale së bashku me Junikun dhe Mamushen. Pas tri viteve ka marrë statusin e plotë të komunës, duke formuar të gjitha organet dhe bazën juridike komunale. Territori i Komunës së Hanit të Elezit më herët ka qenë pjesë administrative dhe qeverisëse e Komunës së Kaçanikut.

Ecuria e përgjithshme e qeverisjes gjatë dy viteve të kaluara në Komunën e Hanit të Elezit ka pasur rrjedhë progresive, veçmas gjendja paraqitet më e mirë në infrastrukturë lokale dhe në menaxhimin e shërbimeve publike.

Angazhimi institucional i autoriteteve të Hanit të Elezit në zgjidhjen e problemeve me të cilat është përballur ky lokalitet ka qenë inkurajues. Ndotja e madhe e ajrit nga fabrika e çimentos “Sharr Cem” tani është zvogëluar dukshëm dhe për këtë ka merita edhe Komuna e Hanit të Elezit. Kryetari i Komunës ka lobuar fuqishëm që të largohet nga përdorimi zyrtar në të gjitha shkresat emërtimi serb i komunës si “Gjenerali Jankoviq”. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vendosur në favor të Komunës së Hanit të Elezit për largimin e këtij emërtimi nga përdorimi zyrtar.

Sa i përket shpenzimit të buxhetit në linjën e mallërave dhe shërbimeve, përkatësisht për dreka dhe darka, ka një shfrytëzim jo të duhur të buxhetit. Shifrat e shpenzuara nuk janë të larta, por janë hasur raste kur brenda një dite janë bërë fatura për 11 dreka zyrtare.

Instituti GAP ka evidentuar dhe vlerësuar zhvillimet e përgjithshme në këtë komunë, që përfshinë evidentimin e problemeve, mangësive dhe vështirësive kryesore, pasqyrimin e nivelit të investimeve kapitale, mënyrën e shfrytëzimit dhe shpenzimit të parasë publike, transparencën komunale, prokurimin publik, funksionimin e administratës dhe të vetë ekzekutivit. Në pjesën e fundit të këtij raporti janë vlerësuar ndaras të gjitha premtimet e dhëna nga Kryetari i Komunës gjatë fushatës zgjedhore dhe niveli i realizueshmërisë së tyre deri me tani.

1. Problemet në Komunën e Hanit të Elezit

Një nga problemet me të cilat përballën qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit është mungesa e çerdheve publike, ku në këtë komunë nuk ka asnjë të tillë. Autoritetet lokale nuk kanë ndërmarrë ndonjë nismë për zgjidhjen e këtij problemi. Premtimi i një organizate holandeze që do të ndërtojë një çerdhe publike në fshatin Seçishtë, akoma nuk është konkretizuar.

Problem evident në Komunën e Hanit të Elezit vlerësohet edhe mungesa e menaxhimit të burimeve të ujit të pijes si dhe mbeturinave. Me ujin nuk menaxhon asnjë ndërmarrje, ndërsa gypat e ujit në territorin e komunës vijnë nga dy burime, përkatësisht nga fshati Glloboqic i Kaçanikut dhe nga një burim brenda Hanit të Elezit. Gjendja paraqitet edhe më e keqe në mirëmbajtjen e hapësirave publike si dhe me mbledhjen e mbeturinave. Komuna ka përzgjedhur një kompani private për mbledhjen e mbeturinave, ku megjithë angazhimin gjendja e përgjithshme mbetet larg standardeve të kërkuara.

Komuna e Hanit të Elezit në gjysmën e parë të vitit 2011 ka marr një vendim për themelimin e ndërmarrjes komunale për menaxhimin e ujit dhe mbeturinave, por ky vendim është shpallur i jashtëligjshëm nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kësajsoj kjo ndërmarrje nuk është themeluar.

Problem në Komunën e Hanit të Elezit paraqet edhe përqindja e lartë e kuadrit të pakualifikuar në sistemin arsimor e cila përgjithësisht vlerësohet që ndikon keq në cilësinë e arsimit. Edhe gjendja në shëndetësi përcillet me vështirësi specifike. Numri i stafit mjekësor është tejet i pakët, gjë e cila rezulton në pamundësinë e ofrimit të shërbimeve efikase mjekësore për qytetarët.

Mungesa e sinjalit televiziv të televizioneve me frekuencë kombëtar (RTK, KTV dhe RTV21) për qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit vazhdon të mbetet një mangësi. Shqetësim evident në këtë komunë paraqet edhe mungesa e valëve të operatorit Vala. Në pjesën më të madhe të territorit të Komunës së Hanit të Elezit aktivizohet platforma roaming i cili e bën komunikimin në telefon për banorët shumëfish me të shtrenjtë.

Ndotja dhe mos mirëmbajtja e lumit Lepenc është një tjetër problem për Komunën e Hanit të Elezit. Komuna nuk ka bërë ndonjë investim i cili do të largonte apo pamundësonte derdhjen e gypave të ujërave të zeza në këtë lum.

Ndërtesat e vjetra dhe mos mirëmbajtja e tyre i japin një pamje të shëmtuar qytetit të Hanit të Elezit. Komuna nuk e ka konsideruar deri më tani si prioritet imazhin e qytetit dhe kështu nuk ka bërë ndonjë plan apo investim për gëlqerosjen e ndërtesave të vjetra. Në pamjen jo të mirë të qytetit ndikon edhe mungesa e parkingjeve të duhura për vetura, mungesa e gjelbërimit, ndërtimeve të pa harmonizuara si dhe rrugëve të ngushta.

2. Performanca buxhetore e Komunës së Hanit të Elezit

Të hyrat komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit, por akoma të hyrat e përgjithshme vlerësohen të vogla. Në vitin e fundit (2011) shkalla e të hyrave komunale ka pasur një rritje të konsiderueshme, ku krahasur me vitin 2010 të hyrat janë rritur për 88.000 euro.

Tabela nr.1: Shkalla e të hyrave komunale (Krahasim mes vitesh)

| Viti | Shuma (Euro) |
|------|--------------|
| 2009 | 217.000 |
| 2010 | 215.000 |
| 2011 | 303.000 |

Fabrika e çimentos në Han të Elezit deri më 2012 ka paguar nga 50.000 euro në vit për tarifë komunale. Tani komuna me rregulloren e re për tarifa dhe ngarkesa komunale e zbritet këtë shumë për 7.000 euro, përkatësisht në 43.000 euro. Zbritje nga tarifat komunale ka pasur edhe ndaj kompanive gur-thyese. Ato deri tani kanë paguar 1.500 euro, ndërsa prej tani do paguajnë nga 1.200 euro në vit. Dy herë radhazi Komuna ka ndryshuar Rregulloren komunale për ngarkesa, gjoha dhe tarifa komunale, duke ulur tarifat për bizneset dhe duke nivelizuar tatimet për lloje të ndryshme biznesesh. Me rregulloren e re tarifore biznese të natyrave të ndryshme paguajnë tatime të njëjta. Për shembull, një argjendarë dhe bukëpjekësit taksohen njësojë, në vlerën e 80 eurove në vit. Apo libraritë kanë taksë vjetore në vlerën e 80 eurove, ndërsa butiqet në vlerën e 48 eurove, 80 euro është llogaritur edhe vlera e taksës vjetore për ushtrimin e profesionit të avokatit, ndërsa shitja e mishit taksohet në vlerën e 120 eurove.

Tabela nr.2: Buxheti për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2011

| Përshkrimi | Shuma (Euro) |
|----------------------|---------------------|
| Investime kapitale | 396.836 |
| Subvencione | 8.251 |
| Shpenzime kapitale | 29.528 |
| Mallëra dhe shërbime | 150.696 |
| Paga | 952.327 |
| Gjithsej | 1.537.638 |

Shuma totale e buxhetit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2011 ka qenë 1.537.638 euro, kurse buxheti i Komunës për 2012 është 1.686.727 euro.

Sa i përket mënyrës së shpenzimit të buxhetit, në përgjithësi kjo komunë nuk ka shpenzime të mëdha në linjën e mallrave dhe shërbimeve, përveç në rastin e vitit të fundit (2011) në kategorinë e mirëmbajtjes së automjeteve zyrtare si dhe në rastin e drekave dhe darkave për vitin 2010. Në këto dy raste është hasur shifër e konsiderueshme e mjeteve të shpenzuara, krahasuar me fushat e tjera.

Tabela nr.3: Shpenzimet në disa nga kategoritë në Komunën e Hanit të Elezit

| Kategoria | 2011 | 2010 | 2009 | 2008 |
|----------------------------|--------------------------|-------------|-------------|-------------|
| Udhëtime | 2.198 € | 13.681 € | 4.000 € | 11.000 € |
| Telefon | 2.450 € | 3.762 € | 4.000 € | 4.000 € |
| Dreka zyrtare | 13.526.86 € ¹ | 22.079 € | 12.000 € | 12.000 € |
| Mirëmbajtje të automjeteve | 12.834 € | - | - | - |
| Derivate për Vetura | 21.896.47 € | - | - | - |

Për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, Komuna e Hanit të Elezit gjatë vitit 2011 ka shpenzuar 12.834 euro, shumë kjo shumëfish më e lartë se sa mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve publike për të cilën kategori janë shpenzuar gjatë 4.936 euro.

Zyra e Kryetarit nuk rezulton të ketë shpenzuar para gjatë 2011 për derivate të veturave. Shpenzimet në këtë linje mbi 95 % janë krijuar nga Drejtoria e Administratës si dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Po ashtu Komuna e Hanit të Elezit nuk ka shpenzuar

¹ Shpenzimi është bërë vetëm nga Zyra e Kryetarit – Raporti i buxhetit i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2011.

asnjë cent për ushqim dhe pije gjatë 2011, linjë kjo që del jashtë shpenzimeve për dreka dhe darka dhe po ashtu nuk janë hasur shpenzime gjatë 2010 dhe 2011 për meditime apo bonuse.

Në bazë të tabelës së buxhetit të Komunës së Hanit të Elezit rezulton se kjo komunë ka gjithsej 34.000 euro fatura të papaguara nga viti 2011 dhe pjesa më e madhe e këtyre faturave lidhen me shpenzimet e bëra në Picerinë "Alba". Nga borxhet hasen faturime në vlera 10 euro, 9 apo 17 euro dhe që të gjitha janë të emertuara si 'dreka zyrtare' të bëra që të gjitha në picerinë "Alba". Po ashtu në bazë të kësaj liste rezulton se brenda një dite 11 fatura janë regjistruar si 'dreka zyrtare', ndonëse vlera e 11 faturave nuk e kalon shumën e 200 eurove.

Një karakteristikë e cila vihet në pah te Komuna e Hanit të Elezit është shpenzimi i mjeteve për linjën e ashtuquajtur 'për përfituesit individual' ku gjatë vitit të fundit (2011) në këtë kategori janë shpenzuar 22.713,80 euro. Këtu nuk llogariten mjetet financiare në shumën prej 9.000 euro të cilat gjatë vitit 2011 janë shpenzuar për familjet e viktimave të luftës së fundit. Dedikimi i këtyre mjeteve do të duhet të përcillet me hartimin dhe miratimin e një rregullore komunale ku do të specifikoheshin mënyrat apo kriteret e përfitimit të këtyre mjeteve, veçmas në linjën 'për përfituesit individual'. Nga lista e akteve komunale të miratuara nga Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit nuk haset ndonjë dokument i cili e rregullon këtë sferë. Mungesa e një akti të tillë lë hapësirë për gabime dhe keq orientime në këtë pikë.

Në raportin vjetor të Auditorit të Përgjithshëm (2012) i cili i referohet vitit 2011 thuhet se në Komunën e Hanit të Elezit një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin në pronë. Faturimet nga Komuna për lejet e biznesit dhe të ardhurat nga qiraja nuk regjistrohen. Këto të hyra regjistrohen vetëm si para të gatshme. Po ashtu në këtë raport evidentohet se Komuna nuk merr listën nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për numrin total të bizneseve aktive në Komunë. Si pasojë, biznese joaktive ose të mbyllura mund të ngarkohen me taksa, ndërsa bizneset aktive mund të mos ngarkohen me obligimin përkatës ose të shmangen nga këto obligime. Si përfundim ZAP-i kërkon nga Komuna e Hanit të Elezit që të bëjë përmirësime në fushat e të hyrave, të prokurimit, paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj, pagimi i detyrimeve brenda afatit të kërkuar, vlerësimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale dhe krijimi i komitetit të auditimit dhe zyrës së auditimit të brendshëm.²

² Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Pasqyrat Financiare për Komunën e Hanit të Elezit për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2011. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Hani_i_Elezit_Forma_e_Raportit_ALB_27_qershor_2012_561291.pdf

3. Investimet kapitale

Shuma e investimeve kapitale në Han të Elezit gjatë një viti nga buxheti komunal sillet në afërsisht 400.000 euro. Karakteristikë e investimeve kapitale në këtë komunë gjatë viteve të fundit kanë qenë investimet e ndryshme të bëra nga ana e donatorëve ndërkombëtarë, por edhe nga Qeveria e Kosovës. Viti i karakterizuar me investime të dukshme nga donatorët ka qenë 2010, ku shuma totale e investuar në këtë komunë vetëm nga donatorët ka kapur shifrën e 2.618.791,69 euro. Ndërkaq një vit me herët (2009) kanë qenë gjithsej 154.000 euro të investuara nga donatorët, në vitin e fundit (2011) janë investuar gjithsej 715.921,90 euro. Ndërsa për vitin 2012 shuma që pret Komuna e Hanit të Elezit për t'u investuar nga donatorët është 844.200,50 euro.

Nga kjo rezulton se gjatë këtyre 4 viteve, duke përfshirë edhe zotimet e donatorëve për këtë vit (2012), në Komunën të Hanit të Elezit vetëm nga donatorët do të jenë investuar rreth 4.3 milionë euro.

Tabelën nr.4: Investimet e bëra nga donatorët në Komunën e Hanit të Elezit gjatë dy viteve të kaluara (2010 -2011)

| Emri i Projektit | Donatori | Shuma |
|--|--|---------|
| Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit - Dimcë | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | 100.000 |
| Renovimi i shkollës "Ilaz Thaçi" | Logos-Zvicër | 20.000 |
| Rregullimi i kanalit të ujit në Han të Elezit | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 107.000 |
| Salla e Sporteve në shkollën "Ilaz Thaçi" | Komisioni Evropian | 303.000 |
| Fusha Sporti të jashtme ne shkollën "Ilaz Thaçi" | Komisioni Evropian | 63.000 |
| Fontana e Qytetit | Komisioni Evropian | 40.000 |
| Asfaltimi i rrugës tek vendi i quajtur "Lagjja e re" | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë | 230.000 |
| Rregullimi i shtratit të lumit "Lepenc" | Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor | 250.000 |

| | | |
|---|--------------|--------|
| Përcaktimi i kufijve kadastral | UNDP | 16.000 |
| Rregullimi i rrugës prej lagjes së Krasniqëve | Logos-Zvicër | 40.000 |

Investimet kapitale përgjithësisht në Komunën e Hanit të Elezit janë shtrirë në asfaltimin e rrugëve dhe rregullimin e trotuareve. Kjo sferë e investimeve nuk mund të vlerësohet e përmbyllur në këtë komunë, ngase ka akoma disa rrugë me gjatësi relativisht të mëdha që nuk janë rregulluar, si dhe vetë infrastruktura e përgjithshme në qytet kërkon ndërhyrje shtesë në shumë lagje të këtij vendbanimi. Brenda qytetit mund të hasen rrugë me gropa dhe po ashtu disa rrugë esenciale të qytetit nuk kanë trotuar për këmbësor.

Tabela nr.5: Investimet kapitale të Komunës së Hanit të Elezit të realizuara gjatë vitit 2010 dhe 2011

| Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010 -2011 | Vlera (euro) |
|---|----------------|
| Asfaltimi i rrugës Hani i Elezit - Varrezat e dëshmorëve | 4.969 |
| Asfaltimi i rrugës në lagjen "Kallamoqe" | 14.871 |
| Ndërtimi i objekteve në zonën e quajtur Goranc | 19.899 |
| Kanalizimi në fshatin Meliq | 29.500 |
| Rregullimi i rrugës nga vendi i quajtur Uji i thartë deri në Pustenik | 29.654 |
| Instalimi i ndriçimit publik në zonën e qendrës së qytetit | 9.995 |
| Segmentet e kanalizimit të fshatit Paldenicë - Hani i Elezit | 38.767 |
| Ujësjellësi në fshatin Dimcë | 178.000 |
| Rregullimi i sheshit të qytetit | 30.000 |
| Aneksi i shkollës fillore në fshatin Paldenicë | 21.000 |
| Kanalizimi i fshatit Seçishtë | 17.127 |
| Asfaltimi i Rrugës Kotlinë- Laç, dhe Lagja e Re | 17.000 |
| Rregullimi i rrugicave me kubëza betoni në qytetin e Hanit të Elezit | 45.314 |
| Shkallët emergjente të shkollës fillore "Ilaz Thaçi" | 15.538 |
| Gjithsejtë | 471.634 |

Nga tabela e mësipërme vërehet se projektet në shuma të mëdha janë mbuluar financiarisht nga ana e donatorëve të ndryshëm, kryesisht nga ministritë e linjës së Qeverisë së Kosovës.

4. Aktivitetet e Prokurimit Publik 2010 - 2011

Njësia e Prokurimit në Komunën e Hanit të Elezit, sipas organo-gramit të administratës së komunës, funksionon në kuadër të Drejtorisë së Administratës. Për dy vite (2010-2011) Komuna e Hanit të Elezit ka lidhur nëpërmjet procedurave të prokurimit 141 kontrata në vlerë të përgjithshme mbi 1.3 milionë euro. Janë disa raste kur procedurat e prokurimit janë kryer nga ana e Komunës së Hanit të Elezit, ndërsa mjetet kanë qenë të dedikuara për projekte të caktuara nga ana e institucioneve qendrore të Kosovës.

Tabela nr.6: Kontratat e Prokurimit në Komunën Hanit të Elezit

| Viti | Nr. i kontratave | Vlera e kontratave (Euro) |
|--------|------------------|---------------------------|
| 2010 | 77 | 459.666,19 |
| 2011 | 64 | 857.847,87 |
| Totali | 141 | 1.317.514,06 |

Burimi: KRPP Raporti për 2010 dhe 2011

Shefi i prokurimit në Komunë të Hanit të Elezit, Xhevdet Bushi, është nipi i Kryetarit (djali i motrës së kryetarit). Kjo është vlerësuar si potencialisht e dëmshme edhe nga partitë (LDK dhe AAK) të cilat janë në koalicion me kryetarin Refki Suma. Edhe LDK edhe AAK i kanë kërkuar kryetarin që z.Bushi ta largojë apo transferojë në ndonjë pozitë tjetër, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Në raportet e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për vitet 2010 dhe 2011 nuk evidentohet ndonjë vendim apo masë ndëshkuese ndaj autoriteteve të Komunës së Hanit të Elezit për shpërfillje të rregullave të Prokurimit Publik. Po ashtu edhe Auditori i Përgjithshëm i vendit (ZAP) në raportin e këtij viti (2012) i cili i referohet periudhës së vitit të kaluar (2011) nuk raporton të gjetura në sferën e prokurimit publik në Komunën e Hanit të Elezit, përveç se rekomandon ashpërsimin e masave për respektimin e dinamikës së punimeve në përputhje me kontratat e lidhura publike.

5. Administrata e Komunës së Hanit të Elezit

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunë e Hanit të Elezit është 206 persona duke përfshirë këtu edhe të punësuarit në sektorin e arsimit fillor dhe të mesëm dhe në sferën e shëndetësisë. Ndërkaq nga ky numër, 60 të punësuar janë në dikasteret e ndryshme në Komunë.

Mbetet shqetësuese numri tejet i vogël i femrave të punësuar në dikasteret e përgjithshme të Komunës. Nga tetë drejtori sa ka Komuna e Hanit të Elezit asnjë nuk udhëhiqet nga femrat, përderisa nga 60 të punësuar në dikasteret e Komunës së Hanit të Elezit vetëm 4 janë të gjinisë femërore, përderisa 57 janë meshkuj.

Tabela nr.7: Numri i të punësuarëve sipas sektorëve në Komunën e Hanit të Elezit

| Sektorët | Numri i të punësuarve |
|--|-----------------------|
| Zyra e Kryetarit | 6 |
| Drejtoria e Administratës | 17 |
| Drejtoria e Financave | 8 |
| Drejtoria e Urbanizimit | 13 |
| Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik | 2 |
| Spektori i Arsimit/ para fillor/ fillor dhe i mesëm/ Drejtoria e Arsimit | 118 |
| Spektori i Shëndetësisë/ Drejtoria e Shëndetësisë | 33 |
| Zjarrfikës/ shërbimet publike/ rojtar pylli | 13 |
| Zyra për komunitete | 1 |
| Gjithsejtë | 211 |

Nga tabela e mësipërme vihet në pah një ndarje jo e drejtë e të punësuarve varësisht nga Drejtoritë. Territori i Komunës së Hanit të Elezit nuk është aq i gjerë dhe kësaj numri i të punësuarve në Drejtorinë e Urbanizimit prej 13 personave rezulton të jetë relativisht i lartë, përderisa Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik i ka gjithsej 2 të punësuar.

Nga gjithsejtë 60 të punësuar në Komunë të Hanit të Elezit, 31 prej tyre janë me fakultet, 22 me shkollim të mesëm, 6 me shkollim fillor dhe 2 me shkollim të lartë. Nga 31 me fakultet një pjesë e tyre janë staf politik (Kryetari, nënkryetari, drejtorët).

6. Arsimi në Komunën e Hanit të Elezit

Në Komunën e Hanit të Elezit janë gjithsej tetë shkolla fillore dhe një shkollë e mesme. Numri i mësimdhënësve në shkollat fillore në Komunën e Hanit të Elezit është gjithsejtë

80, prej tyre 35 janë të gjinisë femërore dhe 45 janë meshkuj. Ndërsa në tetë Shkollat fillore punojnë edhe 15 ndihmës administrativo-teknikë.

Tabela nr.8: Numri i përgjithshëm i nxënësve në tetë shkollat fillore në Komunën e Hanit të Elezit

| Numri i nxënësve | Femra | Meshkuj |
|------------------|------------|------------|
| 1.496 | 723 | 773 |

Në Komunën e Hanit të Elezit ekziston vetëm një shkollë e mesme (SH.M. "Dardania") e cila ofron mësim të profilit të përzier të gjimnazit dhe shkollës profesionale apo teknike. Shkolla e mesme ka të punësuar gjithsej 20 mësimdhënës, 7 prej tyre femra. Shkolla po ashtu ka të punësuar 3 punonjës teknikë.

Tabela nr.9: Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollën e mesme "Dardania" në Komunën e Hanit të Elezit

| Numri i nxënësve | Femra | Meshkuj |
|------------------|------------|------------|
| 469 | 220 | 249 |

Tabela nr.10: Numri total i nxënësve në tetë Shkolla Fillore dhe një Shkollë të Mesme dhe përqindja e ilustruar nga këndvështrimi i perspektives gjinore

| Numri total i nxënësve | Femra | Meshkuj |
|------------------------|------------|-------------|
| 1.965 | 943 | 1022 |
| | 46% | 54% |

Në Komunë të Hanit të Elezit po ashtu përveç 1.965 nxënësve të shkollave fillore dhe asaj të mesme, numërohen edhe 134 nxënës para shkollor.

Tabela nr.11: Numri total i mësimdhënësve në tetë Shkolla fillore dhe një Shkollë të mesme dhe përqindja e ilustruar nga këndvështrimi i perspektives gjinore

| Numri total i mësimdhënësve | Femra | Meshkuj |
|-----------------------------|------------|------------|
| 100 | 42 | 58 |
| | 40% | 60% |

Në sferën e arsimit, Komuna e Hanit të Elezit ballafaqohet me prezencë të kuadrit të pakualifikuar dhe njëherazi një përqindje e konsiderueshme e kuadrit ekzistues vlerësohet të jetë me kualifikim jo adekuat për lëndët të cilat i ligjerojnë. Kjo gjendje është e evidente në vitet e fundit në sistemin arsimor të Komunës së Hanit të Elezit dhe

deri tani nuk ka pasur ndonjë strategji komunale për ndryshimin e kësaj gjendje e cila vlerësohet sfiduese edhe nga vetë krerët komunalë.

Tabela nr.12: Përqindja e mësimeve të pakualifikuara dhe atyre me kualifikim jo adekuat në Komunën e Hanit të Elezit

| Kategoria | I/e kualifikuar | I/e pa kualifikuar | I/e pa kualifikim adekuat |
|-----------|-----------------|--------------------|---------------------------|
| Numri | 63 | 25 | 12 |
| Përqindja | 62% | 27% | 11% |

Investimet kapitale në objektet arsimore në Komunën e Hanit të Elezit gjatë viteve 2010 dhe 2011 kanë qenë sipërfaqësore. Komuna ka nisur me dezinfektimin dhe dezinfektimin e objekteve të shkollave, hap ky që ka dhënë rezultate pozitive në mirëmbajtjen e hapësirave shkollore.

Tabela nr.13: Disa nga investimet gjatë 2010 -2011 në infrastrukturën e shkollave në Hanë të Elezit

| Investimet në infrastrukturën e shkollave | Shuma (euro) |
|---|--------------|
| Riparimi i kulmit të shkollës "Ilaz Thaçi" dhe shtrimi i dyshemeve në klasa | 21.967 |
| Ngrohja qendrore në shkollën e Palidences | 20.667 |
| Ndërtimi i shkalleve emergjente për shkollën "Ilaz Thaçi" | 15.538 |
| Aneks objekti për shkollën e Palidences | 55.888 |
| Ndërrimi i dymëve dhe dritareve në tri shkolla fillore | 59.886 |
| Inventar për shkolla (karrige, banka, dërrasa të zeza) | 11.574 |

7. Shëndetësia në Komunën e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit funksionon me gjithsejt dy qendra shëndetësore, gjegjësisht ka një Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe një Qendër të Mjekësisë Familjare në formën e ambulancës e cila është në fshatin Gorancë. Numri i mjekëve të angazhuar në këto qendra vlerësohet i pamjaftueshëm për të ofruar shërbime efikase. Një numër i qytetarëve të Hanit të Elezit akoma i drejtohen Komunës së Kaçanikut për të marrë shërbime shëndetësore, veçmas në fushën e stomatologjisë. Qendra e Mjekësisë Familjare në Gorancë punon vetëm ditëve të punës nga ora 8:00 deri në ora 17:00, ndërsa QKMF punon 24 orë, 7 ditë në javë.

Tabela nr.14: Stafi i punësuar në sektorin e shëndetësisë

| Stafi mjekësor | Numri |
|-----------------------|-----------|
| Mjek i përgjithshëm | 6 |
| Stomatolog | 1 |
| Infermier | 18 |
| Laborant | 1 |
| Infermierë - vaksinim | 1 |
| Mirëmbajtës | 1 |
| Depoistë | 1 |
| Shoferë | 1 |
| Gjithsejtë | 30 |

Vlerësimi i numrit të përgjithshëm të banorëve në Komunën e Hanit të Elezit dhe numrit total të mjekëve rezulton me përafrimin e standardeve që i kërkon Organizata Botërore e Shëndetësisë: një mjek për rreth 2000 banorë.³

Investimet nga Komuna në sistemin shëndetësor kanë qenë kryesisht për mallëra dhe shërbime dhe nuk ka pasur investime kapitale. Komuna nuk ka pasur buxhet për të blerë një autoambulancë për bartjen e pacientëve dhe një e tillë është siguruar nga një donacion ndërkombëtar ("Kosova Support Group" e Irlandes së Veriut).

8. Transparenca

Niveli i transparencës së punës së Komunës së Hanit të Elezit mund të vlerësohet përgjithësisht i kënaqshëm. Komuna ka të formuar Zyrën për marrëdhënie me publikun ku është i punësuar një zyrtar (Bashkim Sopa) i cili në mënyrë të shpejtë u përgjigjet kërkesave të mediave për informata dhe të dhëna që kanë të bëjnë me zhvillimet e ndryshme komunale. Hanit i Elezit nuk ka media lokale, zhvillimet nga ai lokalitet mbulohen kryesisht nga korrespondentët e mediave nga Kaçaniku, të cilët vlerësojnë se nuk ka pasur ndonjë rast kur zyra për informim e Komunës së Hanit të Elezit të ketë hezituar apo kundërshtuar në dhënien e informatave të kërkuara. Lehtësuese paraqitet

³ Intervistë me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunë të Hanit të Elezit, Valbon Krasniqi. Maj 2012.

fakti që edhe zyrtarët e tjerë komunal (Kryetari, Drejtorët e Drejtorive) të Hanit të Elezit u ofrojnë përgjigje mediave dhe qytetarëve në adresimet e tyre. Edhe faqja zyrtare e Komunës së Hanit të Elezit përmban shumëllojshmëri të informatave, raporteve, planeve dhe zhvillimeve tjera që lidhen me Komunën e Hanit të Elezit.

Tabela nr.15: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Hanit të Elezit
<http://kk.rks-gov.net/hanielezit/>

| Dokumenti | 2010 | | | | 2011 | | | | 2012 |
|---|------|----|------|----|------|----|-----|----|------|
| | I | II | II I | IV | I | II | III | IV | I |
| Raporti i Punës së Kryetarit | x | x | x | √ | x | x | x | √ | √ |
| Raporti financiar (buxhetor) i Komunës | x | √ | x | √ | x | √ | √ | √ | √ |
| Raportet e Drejtorisë së Administratës | x | x | x | √ | x | x | x | √ | x |
| Raportet e Drejtorisë së Arsimit | x | x | x | √ | x | x | x | √ | x |
| Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mir.Sociale | x | x | x | √ | x | x | x | √ | x |
| Raportet e Drejtorisë së Inspektionit | x | x | x | √ | x | x | x | √ | x |
| Financa, Ekonomi dhe Zhvillim | x | x | x | √ | x | x | x | √ | x |
| Urbanizmi, Kadastru dhe Mjedesi | x | x | x | √ | x | x | x | √ | x |
| Shërbimet Publike | x | x | x | √ | x | x | x | √ | x |
| Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | x | x | x | √ | x | x | x | √ | x |
| Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit | | | | | √ | | | | |
| Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm | | | | | x | | | | |
| Procesverbalet e Kuvendit Komunal | √ | | | | √ | | | | √ |
| Rregulloret Komunale | | | | | √ | | | | |
| Vendimet e Kuvendit Komunal | √ | | | | √ | | | | √ |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal | x | | | | | | | | | |
| Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa | x | x | x | x | x | x | x | x | x | x |
| Planet dhe Strategjitë e Komunës | √ | | | | | | | | | |

X = mungon raporti.

√= raporti është i publikuar në ueb-faqe

9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z. **Refki Suma**, elektoratit të tij i ka dhënë 13 premtime për sfera të ndryshme. Pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, më 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit ia përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre.

Tabela më poshtë vlerëson progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna më 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 13 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas dy viteve të qeverisjes në komunën së Hanit të Elezit, 6 premtime janë përmbushur, 4 nuk janë realizuar, ndërsa 3 premtim ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por akoma nuk mund të vlerësohen të përmbyllura.

| Premtimet | Realizueshmëria |
|--|---|
| Menaxhimin e drejtë dhe ngritjen e kapaciteteve në administratën komunale | GAP nuk ka gjetur të dhëna për keq-menaxhim në administratën komunale, ndërsa ngritja e kapaciteteve komunale kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm, por të dhënat flasin se punësimet në administratën komunale bëhen përgjithësisht duke u favorizuar personat me tituj universitar. |
| Mbrojtjen e ambientit me anë të vendosjes së një aparati i cili do të bëjë matjen e gazrave të ndryshme që lirohen dhe vendosjes së filtrave në kompaninë e çimentores | Vendosja e filtrave në kompaninë e çimentos nuk është kompetencë komunale dhe komuna nuk mund të ushtrojë autoritet mbi këtë ndërmarrje, por ka arritur në mënyrë të efektshme që të ndikojë të përgjegjësit e fabrikës së çimentos që ata të investojnë në mbrojtjen ambientale nga tymi dhe gazërat e ndryshme. Ndërsa premtimi për vendosjen e një aparature të sofistikuar për matjen e cilësisë së ajrit nuk është bërë. |
| Rregullimin e infrastrukturës rrugore | Përgjithësisht ka pasur progres në këtë drejtim. |
| Përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe atyre sociale | Në këtë drejtim janë vërejtur investime dhe përmirësime evidente. Ka qenë inkurajuese hapi i komunës për t'i paguar bartjen e pacienteve me hemodializë si |

| | |
|---|---|
| | dhe investime ka pasur në infrastrukturën e QMF në Hanë të Elezit. |
| Përmirësimin e kushteve në arsim | Infrastruktura shkollore e Hanit të Elezit mund të vlerësohet me e dobëta në vend edhe për kundër përpjekjeve solide të autoriteteve komunale dhe donatorëve ndërkombëtarë që ajo të përmirësohet. Shqetësuese mbetet fakti i numrit të madh të mësimitdhënësve në këtë komunë që janë të pa-kualifikuar apo gjysmë të kualifikuar dhe shumë raste janë hasur kur kualifikimet nuk janë adekuate për lëndët që ofrojnë. |
| Krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e biznesit | Nuk ka pasur ndonjë projekt konkret komunal i cili është ndërmarrë për këtë qëllim, përjashtimisht ri-hartimit të rregullores komunale për tarifa dhe ngarkesa komunale ku komuna ka zbritur ato për shumicën dërrmues të biznesit në këtë komunë. |
| Përkujdesjen ndaj familjeve të dëshmorëve dhe atyre të dala nga lufta | Ekziston një gatishmëri e udhëheqëseve komunal për t'u angazhuar për këto kategori. Ka pasur disa shtëpi të ndërtuara për invalidët e luftës si dhe janë marrë masa që këto kategori të lirohen nga pagesa në shumë shërbime komunale. |
| Vënia e shtëpisë së zjarrfikësve në funksion 24 orësh | Qendra është krijuar por akoma nuk është funksionale dhe në pjesën dërrmuese të rasteve fikja eventuale e zjarrëve mundësohet nga brigada e zjarrfikësve të Kaçanikut. |
| Shndërrimin e nënstacionit policor në stacion policor | Kjo nuk është bërë. Kjo është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. |
| Krijimin e kompanisë publike për mirëmbajtjen e mbeturinave | Kjo nuk është bërë. Menaxhimin e mbeturinave e kryen kompania regjionale "Pastërtia". |
| Krijimin e kompanisë publike për menaxhimin e ujit të pijshëm | Kjo nuk është bërë. Përpjekje ka pasur, por kanë rezultuar të pa-efektshme, ngase MAPL e ka hedhur poshtë si të jashtëligjshëm një vendim të kësaj komune për të krijuar një kompanie të tillë. |

| | |
|--|---|
| Përfundimin e rrugës Hani i Elezit - Pal - Denic | Kjo është bërë dhe ka qenë bashkëfinancim mes Komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës. |
| Rregullimin e rrugës për fshatin Gorancë, rrugës së fshatit Dimc, si dhe rrugës për te varrezat e dëshmorëve | Kjo është bërë pjesërisht, ngase rruga për në fshatin Dimc akoma nuk është finalizuar e tëra, ndërsa rruga për në fshatin Goranc është përfunduar, e përfunduar vlerësohet edhe rruga për te varrezat e dëshmoreve. |

10. Burimet:

1. Raporti i Financave për vitin 2010 i Komunës së Hanit të Elezit
2. Raporti i Financave për vitin 2011 i Komunës së Hanit të Elezit
3. Lista e të punësuarëve në administratën komunale, arsim dhe shëndetësi në Komunën e Hanit të Elezit
4. Raporti i punës së Komunës së Hanit të Elezit 2010
5. Komuna e Hanit të Elezit. Lista e investimeve kapitale 2010 – 2011 .
6. Raporti Financiarë 2010 dhe Raporti Financiarë 2011 i Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës - <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiendrore.aspx>
Tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2011.zip - ZIP archive, unpacked size 9,843,200 bytes &
7. Raporti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal mbi kapacitetet e komunave - <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/6e66e269-2774-4983-9348-e4f2072e17e7/Raport-mbi-vleresimin-e-kapaciteteve-te-komunave.aspx>
8. Raportet vjetore 2010 -2011 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114
9. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik. Njoftimet e publikuara për Komunën e Hanit të Elezit për vitet 2010, 2011 dhe gjashtëmujorin e parë të 2012.
10. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Hanit të Elezit. Burimi: http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=114
11. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011-2012. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
12. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Hani_i_Elezit_Raporti_ALB_937930.pdf
13. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010. Burimi: http://www.oag-rks.org/repository/docs/Hani_i_Elezit_Forma_e_Raportit_ALB_27_qershor_2012_561291.pdf